

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

**Ligjet dhe tatimet në
Kosovë
(Zgjidhjet)**

P4

Data 16/10/2022

Pjesa A. Detyra me zgjidhje të shumëfishtë (vëtëm një opsion i saktë) Nga 2 pikë secila

1. Fatura në vlerë prej 15,800.00 Euro nga një kompani Kosovare për një kompani në Gjermani i dedikohet shërbimeve të arkitekturës për një hotel në Brezovicë. Sa duhet te jete vlera e TVSH në këtë faturë?
 - a) 1,264,00 Euro;
 - b) 2,844.00 Euro;**
 - c) 00.00 Euro;
 - d) 2,410.19 Euro.

2. Ekstrat SH.P.K gjate viti 2021 ka pranuar fatura te rregullta me TVSH në vlerë prej 220,800 EUR pluse TVSh me normën standarde dhe 15,200 EUR vlera e faturave plus TVSH-ja me normën e reduktuar.

Pasi që Ekstrat SH.P.K ka shitje me të drejt zbritje të TVSH-se dhe pa të drejt zbritje të TVSH-së. Ne ketë vite aplikoj koeficientin e zbritjeve nga viti i kaluar 70%. Ne funde te viti 2021, rezulton së koeficient i zbritjes ishte 60%. Sa është vlera e TVSH-së për rregullim.

 - a) 4,096.00 Euro rritja e TVSh -së të llogaritur;**
 - b) 4,096.00 Euro rritja e TVSH-së të zbritshëm;
 - c) 40,960.00 Euro zvogëlim të TVSH-se se llogaritur
 - d) 40,960.00 Euro zvogëlim te TVSH-se të zbritshëm.

3. Erëza për muajin Shtator 2022 ka realizuar të ardhura bruto në shumë prej 420 EUR dhe një bonus prej 80 EUR . Sa janë obligimet tatimore për ketë muaj që punëdhënësi duhet ndal në burim:
 - a) 26.32 Euro;
 - b) 18.72 Euro;
 - c) 25.30 Euro;**
 - d) 26.72 Euro.

4. Erëza për muajin Shtator 2022 ka realizuar të ardhura bruto në shumë prej 420 EUR dhe një bonus prej 80 EUR. Sa është shuma e kontributit pensional për ketë muaj që

punëdhënësi duhet paguar si kombinim i pjesës së detyrueshme të pensionit nga e punësuar dhe punëdhënësi:

a) 50.00 Euro;

b) 25.00 Euro;

c) 84.00 Euro;

d) 42.00 Euro.

5. Një person i tatueshëm ke de drejtën e kërkesës për rimbursim të TVSH –se nëse:

a) Ka kreditim 3,000.00 Euro brenda një periudhe tatimore;

b) Ka kreditim çfarëdo shume brenda një periudhe tatimore;

c) Sipas dakordimit me ATK;

d)) Ka kreditim në total 3,000.00 Euro pas tri periudhave vazhdueshme tatimore në kreditim.

6. Një person i tatueshëm eksportues i rregullt ke de drejtën e kërkesës për rimbursim të TVSH –se nëse:

a) Ka kreditim 3,000.00 Euro brenda një periudhe tatimore;

b) Ka kreditim çfarëdo shume brenda një periudhe tatimore;

c) Sipas dakordimit me ATK;

d)) Ka kreditim në total 3,000.00 Euro pas tri periudhave vazhdueshme tatimore në kreditim.

7. Sipas Ligjit Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave në fuqi, nëse një shoqëri tregtare ka fitim para tatimit 120,000 EUR, sa është shuma e sponsorizimit për sporte e lejuar për këtë kompani?

a) 12,000 Euro;

b) 6,000 Euro;

c) 1,200.00 Euro;

d) 3,600.00 Euro.

8. Sipas Ligjit Për Tatimin ne te Ardhurat e Personale në fuqi, nëse një shoqëri tregtare ka fitim para tatimit 120,000 EUR, sa është shuma e sponsorizimit për sporte e lejuar për këtë kompani?

- a) 12,000 Euro;
- b) 6,000 Euro;
- c) 1,200.00 Euro;
- d) 3,600.00 Euro.

9. Kompania Blini SH.P.K ka bere riparimin e zyrave të marruar me qira, vlera e këtij riparimi është 20,000 EUR. Kontrata e qirasë për përdorim të zyrave është për periudhe 10 vjeçare. Sa është shuma e lejuar e zhvlerësimit për një vit sipas Tatimin në të Ardhurat e Korporatave?

- a) 4,000.00 Euro;
- b) 1,000.00 Euro;
- c) 2,000 Euro ;
- d) 20,000 Euro.

10. Kompania LIMI B.I e angazhuar në aktivitet ekonomik tregtar me të ardhura vjetore bruto deri në pesëdhjetë mijë euro (50.000 €), të cilët nuk kërkohet dhe nuk kanë zgjedhur të mbajnë librat dhe regjistrimet e listuar në nenin 33, paragrafin 5 të këtij ligj (nuk është i regjistruar për tatimi mbi fitimin real). Për periudhën TM3- 2022 ka faturuar shumën në vlerë prej 9,200 EUR, ndërsa ka inkasuar kesh për këtë periudhe 7,800 EUR, sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale cila është shuma e obligimit tatimore për këtë TM3?

- a) 276.00 Euro;
- b) 828.00 Euro;
- c) 702.00 Euro ;
- d) 234.00 EUR.

Pjesa B. Pyetjet "E saktë/ E pasaktë"

Nga 1 pikë secila

1. Rregullat për lëshimin e lejeve, licencave ose formave të tjera të lejjimit, rregullimi i aktiviteteve në të cilat angazhohet shoqëria tregtare pas regjistrimit, kontabiliteti, raportimi financiar, tatimet si dhe praktikat e punës dhe punësimit të shoqërive tregtare nuk janë në fushëveprim të Ligjit në fuqi "Për Shoqëritë Tregtare.

E saktë

E pasaktë

2. Sipas Ligjit në fuqi "Për Shoqëritë Tregtare me Aksionarë - nënkupton personin fizik që mund të disponojë me të drejtat që janë të përfaqësuara në Aksion..

E saktë

E pasaktë

3. Sipas Ligjit në fuqi "Për Shoqëritë Tregtare, Korporatë - do të thotë një Shoqëri Aksionare, një Ortakëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të regjistruar në Kosovë.

E saktë

E pasaktë

4. Premtimi për kryerjen e punëve ose shërbimeve në të ardhmen nuk kualifikohet si kontribut i vlefshëm dhe nuk kompensohet me aksione.

E saktë

E pasaktë

5. Sipas Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, Shoqëritë tregtare me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme zbatojnë SNK-të dhe SNRF-të, SNRF-të për NVM dhe aktet nënligjore të nxjerra nga KKRF-ja.

E saktë

E pasaktë

6. Ndërmarrjet e vogla janë ndërmarrje të cilat nuk janë mikro-ndërmarrje, por nuk tejkalojnë më shumë se dy(2) nga kriteret e mëposhtme: 1. pasqyra e pozitës financiare prej katër milion euro (4,000,000.00 €) euro; 2. qarkullimi neto prej tetë milion euro (8,000,000.00 €); dhe 3. numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar, pesëdhjetë (50).

E saktë

E pasaktë

7. Ndërmarrësi ose personi përgjegjës nuk kontrollon saktësinë dhe integritetin e dokumentit të kontabilitetit para vendosjes së informacioneve nga dokumenti i kontabilitetit në librat afariste.

E saktë

E pasaktë

8. Shoqëritë tregtare të mëdha në Kosovë zbatojnë SNK-të dhe SNRF-të si dhe interpretimet, rekomandimet dhe këshillimet e nevojshme të nxjerra nga BSNK-ja, që aprovohen nga KKRF-ja. Pasqyrat financiare duhet të kenë të bashkangjitur edhe: *deklaratën e pajtueshmërisë të nënshkruar nga drejtori ekzekutiv dhe zyrtari kryesor financiar, që pasqyrat financiare paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë; dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me Ligjin;*

E saktë

E pasaktë

9. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, një vendim shpjegues publik i lëshuar nga ATK, ka efekt detyrues për Drejtorin e Përgjithshëm lidhur me çdo detyrim tatimor që lind në një periudhë tatimore përpara kohës kur një vendim i tillë është revokuar nga ATK.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm ose zyrtari i autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm me shkrim, mund të kërkojë transferin e posedimit të çdo libri ose regjistri që, për mendimin e Drejtorit të Përgjithshëm ose zyrtarit të autorizuar, siguron provë e cila mund të jetë materiale në përcaktimin e detyrimit të personit sipas legjislacionit tatimor në Kosovë

E saktë

E pasaktë

11. Në qoftë se librat dhe regjistrimet e tatimpaguesit kanë humbur apo janë shkatërruar ose ekzistojnë rrethana tjera që bëjnë të pamundur përcaktimin e detyrimit tatimor, Drejtori i Përgjithshëm do të bëjë një vlerësim bazuar në një parashikim.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas Ligjit në fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat Personale, fitimet kapitale që rezultojnë nga shitjet e pasurive kapitale, duke përfshirë pasurinë e tundshme, të patundshme dhe letrat me vlerë konsiderohen të ardhura të tatueshme.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas Ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat Personale , Të ardhurat bruto nga interesi nuk përfshijnë interesin nga mjetet e Fondit të Kursimeve Pensionale në Kosovë apo nga cilido fond tjetër pensional i përkufizuar sipas legjislacionit përkatës mbi kursimet pensionale në Kosovë

E saktë

E pasaktë

14. Sipas ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, Transferimi i pronës në pajtim me planin e shkruar për riorganizimin e tatimpaguesit qoftë për shkak të bankrotimit, bashkimit, përvetësimit, ndarjes, këmbimit të aksioneve, apo të ndonjë arsyeje tjetër, që e miraton ATK, i nënshtrohet tatimeve sipas këtij ligji.

E saktë

E pasaktë

15. Sipas ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, Çdo tatimpagues që bënë pagesa për personat fizik jo-afarist, bujqit, fermerët, grumbulluesit e materialeve recikluese, frutave të malit, bimëve mjekuese dhe të ngjashme me to, është i obliguar të mbajë tatimin në burim në shkallën prej një përqind (1%) në bruto pagesë, në momentin e pagesës.

E saktë

E pasaktë

16. Sipas ligjit të TVSh-se, Autoritetet e nivelit qendror dhe lokal dhe organet tjera të rregulluara me ligj, nuk duhet të konsiderohen si persona të tatueshëm në lidhje me aktivitetet ose transaksionet, në të cilat angazhohen si autoritete publike edhe atëherë kur mbledhin tagra, taksa, kontribute ose pagesa në lidhje me ato aktivitete ose me ato transaksione.

E saktë

E pasaktë

17. Sipas Ligjit të TVSH-së, shfrytëzimi i mallrave për biznes si mostra apo dhurata me vlerë të vogël, duhet të trajtohet si furnizim i mallrave për konsideratë

E saktë

E pasaktë

18. Sipas Ligjit Për Fondet Pensionale të Kosove, pensionisti është i lirë të zgjedhë njërin nga llojet e pensioneve vjetore vijuese si p.sh: pensionin e veçantë jetësor që paguhet deri në vdekjen e pjesëmarrësit;

E saktë

E pasaktë

19. Sipas Ligjit të Punës ne Kosovës, I punësuari ka të drejtë në pushim javor në kohëzgjatje prej së paku dyzetetë (24) orë pandërprerë.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas Ligjit të Punës ne Kosovës, punëdhënësi në sektorin privat, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës.

E saktë

E pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore

Problemi 1

10 pikë

FFA sh.p.k. regjistroi blerje gjate muajit dhjetor 2021 në shumën Euro 21,000 me normë standarde; blerje me normën e reduktuar Euro 2,000; shitjet vendore me normën standarde Euro 45,000; eksportet Euro 7,000; shitje të përjashtuara pa të drejte kreditimi Euro 12,000.

Deklarimet mujore për këtë vit janë bere duke shfrytëzuar koeficientin e vitit 2020 që ishte 80%.

Pas kalkulimit te koeficientit të zbritshëm për këtë vit (2021) na rezultojë se është 70%.

Blerjet gjate janar- nëntor 2021 me normën standarde 200,000 EURO;

Blerjet gjate janar - nëntor 2021 me normën e reduktuar 18,000 EURO.

Vlerat e paraqitura janë pa përfshire TVSH-ne.

Kërkohe:

- Sa ishte vlera e TVSH-se e zbritshme për këtë muaj?
- Sa ishte vlera e TVSH-se e llogaritur për këtë muaj?
- Sa eshët shuma për rregullim të TVSH-së (TVSH e llogaritur apo TVSH e zbritshme)
- Sa është vlera e TVSH-se e pagueshme për këtë muaj?

Zgjidhje

a) $21,000 \times 18\% = 3,780$ $\times 70\% = 2,646$
 $2,000 \times 8\% = 160$ $\times 70\% = 112$
Totali = 2,646 + 112 = 2,758

b) $45,000 \times 18\% = 8,100$
Exp 7,000
SHP 12,000
TOTAL = 8,100

c)
Rregulimet per te rritur TVSH-në me normë 18%
 $200,000 \times 18\% = 36,000$ $\times 10\% = 3600$
Rregulimet per te rritur TVSH-në me normë 8%
 $18,000 \times 8\% = 1,440$ $\times 10\% = 144$
Totali = 3,600 + 144 = 3,744

$$\begin{aligned} \text{d) TVSH e pag} &= \text{TVSH e llogaritur} + \text{rregullimi} - \text{TVSH e zbritshem} \\ &= 8,100 + 3,744 - 2,758 = 9,086 \end{aligned}$$

Problemi 2

15 pikë

Kompania ndërtimore V & SH Sh.A 31. 12. 2021 tregoj te ardhura prej 2,480,000.00 EUR si dhe kishte shpenzime te përgjithshme 1,150,000.00 EUR,

Informacion shtesë:

1. Shpenzimet e përfaqësimit kapine shume prej 13,000 , nge këto 10% e tyre janë shpenzime zbavitëse (janë te përfshira ne shpenzimet e përgjithshme)
2. Shpenzimet e zhvlerësimit te cilat janë te përfshira ne shpenzimet e përgjithshme kane një vlere prej 18,200.00 Eur . Te këto shpenzime kishte një ndryshim ne mese shkalleve te zhvlerësimit sipas kontabiliteti dhe tatimeve, shpenzimet e kontabilitetit ishin me te larte për 2,500 Eur.
3. Kompania bere një spozorizim tek një klubi sportiv ne vlere prej 45.000 Eur , përmes kontratë marrëveshjeve (ky shpenzim ishte i përfshire ne tërësi tek shpenzimet e përgjithshme).
4. Provizioni për llogarit e arktushme kapine shume prej 6,530 qe ishte vendim i menaxhmentit (janë te përfshira ne shpenzimet e përgjithshme).
5. Pagat e stafit ne vlere prej 10,500 eur për muajin dhjetore do te paguhen ne prill 2022 (nuk janë përfshire ne shpenzimet e përgjithshme)
6. Donacion ne vlere prej 12,000 me dokumentacion (janë të përfshira ne shpenzimet e përgjithshme).

Kërkohet:

Llogaritni obligimin tatimor pas rregullimeve te nevojshme bazuar ne Ligjin mbi te ardhurat e korporatave.

Zgjidhje

Të ardhurat e përgjithshme 2,480,000.00

Shpenzimet e përgjithshme 1,150,000.00

FITIMI para rregullimeve 1,330,000

Rregullimet

Shpenzimet e përfaqësimit 1,300.00

Shpenzimet e zhvlerësimit 2,500.00

Shpenzimet e sponsorizimit 45,000.00

Provizionet 6,530.00

Donacioni 12,000.00

Fitimi para donacionit 1,397,330.00

*Donacioni (12,000.00)

Fitimi para tatimit 1,385,330.00

Tatimi ne fitim 10% 138,533.00

*Sponsorizimi 30% (41,559.90)

**** Obligimi Tatimore 96,973**

1 . Shpenzimet përfaqësimit 13,000 x 10%= 1,300 shpenzimet zbavitëse te papranuara

*** Sponsorizimit** 138533*30%=41559.90

Ligji për sponsorizime I cili pranohet ne nenin 11 pika 1.1 te Ligjit Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave lejohet 30% e tatimit si shpenzim sponsorizimi

****Obligimi tatimor 138,533 – 41,559.90=96,973**

Problemi 3**15 pikë**

Kompania LUNA sh.p.k me seli në Prishtinë kryen aktivitete ekonomike tregtare dhe prodhuese. Gjatë muajit Korrik 2022 ka pasur këto transaksione:

- i. shitjet brenda vendit me norme standarde - shuma e tatueshme 220,000 Euro;
- ii. shitjet brenda vendit me normë të reduktuar - shuma e tatueshme 10,000 Euro;
- iii. Export i produkteve 50,000 Euro;
- iv. shpenzime për shërbime konsulentë të pranuar nga kompania jashtë vendit 4,000 Euro;
- v. shpenzime për shërbime kontabiliteti 900 Euro;
- vi. blerje vendore me normën standarde (lënda e pare) në vlerë 20,000 Euro;
- vii. import me normën standarde (lënda e pare) në vlerë 40,000 Euro(përfshire kostot përcjellëse)
- viii. blerje e veturës brenda vendit për bartje te mallrave në vlere 30,000 Eur;
- ix. shpenzimet tjera për aktivitet ekonomike me norme standarde 2,000 Euro;
- x. shpenzime me kupona fiskal me normën standarde 3,200 Euro;
- xi. shpenzimet tjera për aktivitet ekonomike me norme te reduktuar 1,000 Euro;
- xii. notë kreditore e pranuar me norme 8% ,vlera 900 Euro shuma e tatueshme;
- xiii. notë kreditore e lëshuar me norme 18%, vlera 500 Euro shuma e tatueshme;

Të gjitha blerjet janë nga personat e tatueshëm;
Vlerat e paraqitura janë pa përfshire TVSH-në.

Kërkesa:

Përpiloni ekstraktin e deklaratës së TVSH-së sipas renditjes se sa ka pagesë/kreditim për muajin 07/2022.

Zgjidhje

[TV] FORMULARI I DEKLARIMIT TË TVSH2022				
Periudha e Deklarimit:	.07/2022			
Numri fiskal	800333333			
Emri I biznesit	Luna SH.P.K			
Emri I personit kontaktues	Luna Patrik			
			Furnizimet	
Shitjet e liruar pa te drejtë kreditimi	[9]			
Shitjet e liruar me drejtë kreditimi	[10]			
Eksportet	[11]	50,000.00		TVSH e llog
Shitjet e tatushme me normën 18%	[12]	220,000.00	[13]	39,600.00
Shitjet e tatushme me normën 8%	[14]	10,000.00	[15]	800.00

Nota debitore e leshuar,nota kreditore e pranuar me normë 18%	[16]		[17]	
Nota debitore e leshuar,nota kreditore e pranuar me norme 8%	[18]	900.00	[19]	72.00
Fatura e borxhit te keq e pranuar, inkasimi I B.K me normë 18%	[20]		[21]	
Fatura e borxhit te keq e pranuar, inkasimi I B.K me normë 8%	[22]		[23]	
Rregulimet per te rritur TVSH-në me normë 18%	[24]		[25]	
Rregulimet per te rritur TVSH-në me normë 8%	[26]		[27]	
Blerjet qe I nënshtrohen ngarkesës së kundërt	[28]	4,000.00	[29]	720.00
			[30]	41,192.00

		Blerjet		Totali I TVSH së llog
Blerjet dhe importet pa TVSH	[30]			
Blerjet dhe importet investive pa TVSH	[31]			
Blerjet dhe importet meTVSH jo te zbritshme	[33]	3,200.00		
Blerjet dhe importet investive meTVSH jo te zbritshme	[34]			Tvsh e zbrit
Importet me normë 18%	[35]	40,000.00	[36]	7,200.00
Importet me normë 8%	[37]		[38]	-
Importet investive me normë 18%	[39]		[40]	-
Importet investive me normë 8%	[41]		[42]	
Blerjet vendore me normë 18%	[43]	22,900.00	[44]	4,122.00
Blerjet vendore me normë 8%	[45]	1,000.00	[46]	80.00
Blerjet investive vendore me normë 18%	[47]	30,000.00	[48]	5,400.00
Blerjet investive vendore me normë 8%	[49]		[50]	
Blerjet nga feremrët vendore me normë 8%	[51]		[52]	
Nota debitore e pranuar,nota kreditore e lëshuar me normë 18%	[53]	500.00	[54]	90.00
Nota debitore e pranuar,nota kreditore e lëshuar me normë 8%	[55]		[56]	
Fatura e borxhit te keq e lëshuar, pagesa e borxhit të keq me normë 18%	[57]		[58]	
Fatura e borxhit te keq e lëshuar, pagesa e borxhit të keq me normë 8%	[59]		[60]	
Rregulimet per te ulur TVSH-në me normë 18%	[61]		[62]	
Rregulimet per te ulur TVSH-në me normë 8%	[63]		[64]	
E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	[65]	4,000.00	[66]	720.00
			[67]	17,612.00

		Kalkulimi		Totali I TVSH së Zbr
Teprica e TVSH-së e bartur nga muaji I kaluar	[68]			
Balanca kreditore e mbetur $69=((67+68)-30)>0$	[69]			
Kërkesa për rimbursim	[70]			
Kreditimi I tvsh-së për muajin pasues $71=(69-70)$	[71]			
TVSH që duhet te paguhet $72=(30-67-68)>0$	[72]	23,580.00		

Problemi 4

7 pikë

Pas Aktit të Kontrollit nga ana e ATK-se tek kompania AMC sh.p.k. për periudhën 03/2021 për TVSH rezultojë me obligim shtesë prej 10,200 EUR..

1. Akti i kontrollit u dorëzua tek kompania së bashku me njoftim vlerësimin në Korrik 2022.

2. Deklarim dhe Pagesa e TVSH-se nga kompania për këtë periudhë kishte qenë 15,300 EUR (deklaruar dhe paguar në kohë)

Kërkohe:

Sa janë gjordat dhe intereset përkatëse që aplikohen tek njoftim vlerësimi për tatimin shtesë të dalë nga akti i kontrollit bazuar Ligji mbi Procedurat dhe Administratën Tatimore ?

Zgjidhje

Ndëshkim për mos pagesë në kohë (1% x 12 muaj)	$10,200 \times 12\% = 1,224.00$
Ndëshkim për nen deklarimin tatimore	$10,200 \times 25\% = 2,550.00$
Totali i ndëshkimeve	3,774.00

Interesi (0.65% x 16 muaj)	$10,200 \times 10.40\% = 1060.80$
Totali i ndëshkimeve + Interesi	4,834.80

Problemi 5**5 pike**

Kompania PLASTI SH. P.K me date 31.12.2021 kishte ketë shpenzime te zhvlerësimit sipas kontabilitetit:

Grupi I - 32,500

Grupi II - 26,000

Grupi III - 45,000

Për grupin e pare kompania kishte një politike te zhvlerësimit 5% ne vit, për grupin e dyte 17% dhe për grupin e tret 15% me metodën drejtvizore. Kompania ne muajin tetor të këtij viti kishte blerë një aset te grupit të tret në vlerë prej 50 000 Eur dhe ishte zhvlerësuar në baza mujore.

Te gjitha asetet tjera janë blere gjate vitit 2019.

Kërkohet:

- Llogariten ndryshimin e zhvlerësimit ne mes te kontabilitetit dhe tatimeve sipas grupeve për vitin 2021?
- Cili do te jete shpenzimi shtese për asetin e ri te grupit të tret?

Zgjidhje

	Vlera e astevteve	Kontabiliteti		Tatimet		Diferenca	Ndikim ne tatim
		Shkalla	Shpenzimi	Shkalla	Shpenzimi		
Grupi I	650,000.00	5%	32,500	5%	32,500.00	0	0
Grupi II	152,941.18	17%	26,000	20%	30,588.24	(4,588.24)	zvoglim
Grupi III	287,500.00	15%	43,125	10%	28,750.00	14,375.00	rritje
*Grupi III ast. I ri	50,000.00	15%	1,875	10%	2,500.00	(625.00)	zvoglim
					TOTAL	9,161.76	rritje

***Grupi III ast. I ri per qellime tatimore zhvleresohet 10%/2 pasi qe eshte blere ne gjysmen e dyte te vitit**

Problemi 6

8 pike

Vlera Gashi në muajin Dhjetor 2021 ka pasur rrogën Bruto (primare) prej 750.00 Euro. Në Janar të vitit 2022, menaxhmenti vendosi që paga e Vlerës të rrite për neto vlerë prej 100.00 Euro për shkak të performancës së larte.

Kërkohet:

1. Sa do të jetë paga Bruto në Janar të vitit 2022 për Vleren?
2. Sa do të jete kontributi pensionale?
3. Sa do të jetë tatimin në burim për pagën?

Zgjidhja

	Paga Bruto	Kontributi nga punëtori	Kontributi nga punëdh.	Gjithsej kontributet	Paga që tatohet	Gjithsej taksat	Paga NETO
	a	b=a*5%	c=a*5%	d=b+c	e=a-b	f	g=e-f
Dhjetor 2021	750	37.5	37.5	75	712.5	49.05	663.45

Janar 2022	Niveli	Shuma	Norma tatimore	Tatimi	Paga neto	%	Paga e tatushme	%	Paga Bruto	KP
Paga Neto=663.45+100	a	b= difer.	c	d=b*c	e=b-d	f	g=e/f	h	j=/h	
763.45	0-80	80	0	-	80.00	1.00	80.00	0.95	84.21	
	80-250	170	0.04	6.80	163.20	1.00	170.00	0.95	178.95	
	250-450	200	0.08	16.00	184.00	1.00	200.00	0.95	210.53	
	450-823.61	373.61	0.1	37.36	336.25	0.90	373.61	0.95	393.27	
				60.16	763.45		823.61	0.95	866.96	86.70